



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic
of Kosovo



Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal
Assembly Rahovec

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and
Tourism



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 09 Më Dt. 05.01 2026
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Raporti i punës

Janar–Dhjetor, 2025



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and
Tourism

DATË /A:	04.12.2025
PËR/ZA/TO :	z.Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
NGA/OD/FROM:	z.Erhan Morina, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës për periudhën janar-dhjetor 2025

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm (DEZHT) ka zhvilluar një sërë aktivitete të rëndësishme, me fokus në:

- Inkasimin e borxheve të mbetura nga viti paraprak në sektorin e qirave dhe taksës afariste, që ishte prioriteti kryesor në fillim të vitit.
- Përgatitjen dhe dërgimin e aktvendimeve për të gjitha bizneset e ngarkuara me taksë afariste sipas Rregullores 01 Nr. 80/20.
- Kemi vazhduar vizitat në bizneset lokale, ku gjatë takimeve janë diskutuar të arriturat, sfidat dhe mënyrat e përmirësimit të bashkëpunimit me institucionet publike.
- Monitorimin e punimeve në projektet kapitale, duke përfshirë ndërtimin e Parkut Industrial në Opterushë dhe investimet në shtigje e bujtina turistike.
- Komunikimin e vazhdueshëm me ministrinë përkatëse lidhur me projektet në bashkëfinancim dhe kujdesin për mirëmbajtjen e shtigjeve të ecjes.
- Në kuadër të thirrjes për subvencionimin e bizneseve për vitin 2025, janë përkrahur bizneset të cilat aktivitet kryesor kanë agroturizmin dhe përgatitjen e ushqimeve tradicionale. Në këtë thirrje përfituan gjithsej 11 biznese.

Këto aktivitete kanë kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe turistik të rajonit, si dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe menaxhimin efektiv të projekteve zhvillimore.

Poashtu në muajin qershor, Komuna e Rahovecit ka aplikuar dhe ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR), për realizimin e një projekti të rëndësishëm që përfshin: Ndërtimin e parkingjeve të reja me ndriçim publik, krijimin e hapësirave të gjelbra dhe ndërtimin e rrugës në lagjen e komuniteteve, me një vlerë totale prej 297,908.00 euro. Projekti ka filluar realizimin në terren, ku në muajin shtator, është kubëzuar segmenti i rrugës në varrezat e qytetit si dhe ka filluar të ndërtohet parkingu i veturave te varrezat e qytetit sipas kontratës dhe sipas projektit.

Gjatë kësaj periudhe, DEZHT ka përgatitur disa pika për Kuvendin Komunal të Rahovecit, duke përfshirë:

- Informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale për vitin 2024;
- Vendimin për dhënien në shfrytëzim, përmes shprehjes së interesit, për 99 vite të parcelës së Hotel Park Plaza;
- Dhënien në shfrytëzim të parcelës te Maja e Shkodranit;
- Dhënien në shfrytëzim të kafiterisë në parkun e qytetit;
- Dhënien në shfrytëzim të parcelës te obelisku në Gradish.

Sektorit për Ekonomi;

-Në tre muajin e parë 2025, janë përgatitur aktvendimet për të gjitha bizneset të cilat sipas kodeve ekonomike ngarkohen me taksë afariste. Ndërsa të hyrat vjetore në taksa komunale janë paraqitur në tabelën mëposhtë.

Të hyrat në taksë komunale;

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat në taksë komunale, janar-dhjetor 2025	56,327.00€

Sektorit për Zhvillim;

-Evidenca e të hyrave dhe ngarkesës së qirasë të lokaleve afariste dhe pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit, sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt.

Në periudhën janar-dhjetor 2025, janë lëshuar gjithsej 65 pëlqime të punës dhe janë dërguar me kohë vërejtje për të gjitha bizneset të cilat kanë pasur vonesa në pagesat e qirasë, konform dispozitave ligjore që përcakton rregullorja për taksa komunale 01 NR: 80/20

Të hyrat nga qiratë;

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat nga qiratë, janar-dhjetor 2025	107,412.20€

Zyra e QKRB-së;

-Raporti është i bazuar në planifikimin, objektiva dhe detyrat e punës. Evidenca e regjistrimit të bizneseve të komunës së Rahovecit, sipas bazës së programit online të ARBK-së, mbahet në mënyrë të rregullt.

Tabela e kërkesave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhën janar - dhjetor 2025:

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1	Biznese të reja	181
4	Informata të Bizneseve	65
5	Shuarje të biznesit	19
6	N.U.I.	7
7	Lëndë të anuluar	5
8	Çerteikata duplikat	18
9	Historiat Biznesi	2
10	Ndryshime në biznes	39
11	Vërtetim individual	15
	Gjithsej lëndë të përfunduara	351

Menaxhimi i Aseteve komunale

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, sektori i aseteve komunale ka kryer një sërë detyrash dhe procesesh të rëndësishme në funksion të menaxhimit dhe administrimit të aseteve komunale. Ky raport pasqyron punën e realizuar, duke përfshirë përgatitjen e raporteve në sistemet zyrtare, zhvlerësimin e aseteve, procedurat për shitjen e aseteve të papërdorshme etj.

Pashtu përgjatë periudhës raportuese ky sektor ka kryer këto aktivitete;

1.Përgaditja e raportit në SIMFK dhe E-Pasuria; Një nga aktivitetet kryesore ka qenë përgatitja e raportit tremujor në SIMFK dhe e-Pasuria, në të cilin janë regjistruar dhe përditësuar të gjitha asetet komunale sipas kërkesave ligjore. Raporti pasqyron asetet e reja të shtuara gjatë këtij tremujori, ndryshimet e ndodhura në

vlerën e asetëve ekzistuese dhe gjendjen e përgjithshme të pasurisë komunale. Përdorimi i këtyre sistemeve siguron një menaxhim më efikas dhe transparent të pasurisë publike.

2. Zhvlersimi i asetëve mbi dhe nën 1,000 Euro. Gjatë kësaj periudhe, është realizuar zhvlerësimi i asetëve mbi dhe nën 1,000 Euro, duke u bazuar në gjendjen aktuale të pasurive dhe politikat e menaxhimit të asetëve komunale. Ky proces ka përfshirë rishikimin e vlerës së asetëve të cilat janë amortizuar ose kanë humbur funksionalitetin e tyre. Të gjitha zhvlerësimet janë pasqyruar në sistemet përkatëse për të siguruar që evidenca e pasurive të jetë sa më e saktë dhe në përputhje me standardet financiare.

3. Shitjen e asetëve të papërdorura nëpërmjet ritenderimit. Një tjetër aktivitet i rëndësishëm ka qenë ritenderimi për shitjen e asetëve të papërdorshme. Në këtë kuadër, janë identifikuar asetet të cilat nuk janë më të nevojshme për komunën dhe është ndërmarrë procesi i ritenderimit për t'i shitur ato sipas procedurave të përcaktuara ligjërish. Qëllimi i këtij procesi ka qenë lirimi i hapësirave nga asetet e vjetra dhe krijimi i mundësive për gjenerimin e të ardhurave shtesë për komunën.

4. Në dhjetor, është bërë regjistrimi i të gjitha asetëve komunale.

Sektori i Turizmit

Në kuadër të drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, rol të rëndësishëm paraqet sektori i turizmit, sektor ky, i cili ka në përgjegjësi promovimin e turizmit në komunën tonë. Gjatë periudhës raportuese ky sektor ka kryer një mori aktivitete:

-Pjesëmarrje dhe kontakte të rregullta me organizatën e UNDP-së në lidhje me projektin: Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 - ReLOad2;

-Monitorimi i tre praktikanteve në kuadër të projektit të UNDP-së, skema: Praktikë në punë në kuadër të projektit ReLOad2;

-Puna në grupe në Pejë, ku është bërë shtjellimi i sfidave të sektorit të turizmit, roli i Komunave të Rrafshit të Dukagjinit në sektorin e turizmit. Bashkëpunimin midis Komunave të Rrafshit të Dukagjinit, Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtise, sektorin publik dhe atë privat;

-Mbajtja e kontakteve të rregullta me të gjithë përfaqësuesit e Verarive dhe Bodrumeve të Komunës së Rahovecit;

-Vizitë bizneseve artizanale të cilat merren kryesisht me punë artizanale, ku i kemi marr kontaktet për ti njoftuar lidhur me lansimin e thirrjeve për përkrahje të bizneseve në kuadër të Ministrisë së MINT dhe MZHR-së.

Indikatorët e përfundimit:

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka vetëm dy indikator të përfundimit të cilët janë realizuar 100%.

- Treguesi: 16.1.1 - Strategjia për zhvillim ekonomik lokal 100%.
- Treguesi: 16.1.2 - Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim 100%.

Drejtor i DEZHT

Erhan Morina

